

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe mjedisore” për projektin e filluar në vitin 2008 “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.182, datë 31.12.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 805/18 datë 31.12.2015, dërguar z.Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Referuar marrëveshjes së financimit të kredisë me fondet e Bankës Botërore, konstatohet se projekti “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës” (LAMP), nuk ka realizuar objektivat e përcaktuara sipas marrëveshjeve të financimit, për shkak të nevojave emergjente nga përmytjet e shkaktuara në rrethin e Shkodrës, nga vonesat në kohë që kanë ardhur gjatë procesit të tenderimit si dhe vonesat e pagesave ndaj firmave zbatuese. Gjatë zbatimit të Projektit kanë dalë probleme edhe në lidhje me vështirësitë e bashkive përfituese në plotësimin e standardeve dhe kërkesave të Projektit, veçanërisht në fazën e parë (2 vjet) të zbatimit të tij, të cilat kanë ndikuar në vonesa dhe në mosrealizimin e objektivave të projektit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marrë masat, që për projektet me financime të huaja në të ardhmen, të ndiqet dhe monitorohet realizimi i objektivave, me qëllim arritjen e objektivit kryesor të përcaktuar në marrëveshjet e financimit të kredive, në përputhje me programin e zbatimit, duke respektuar afatet kohore.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Ecuria e disbursimeve ka pasur problematika në vitet e para të zbatimit të projektit përkatësisht, në vitin 2008-2009 disbursimi i fondeve për punime civile të infrastrukturës bashkiake është vonuar për shkak të ngadalësisë në plotësimin standardeve të prokurimit nga ana e bashkive të përfshira në projekt.

Në vitin 2012 fondet e akorduara nga BB dhe fondet që janë gjendje në llogarinë e Bankës së Shtetit, qëndruan në llogarinë speciale të bankës së shtetit për arsye se nuk ishin miratuar firmat e autorizuar për projektin dhe nuk mund të kryenin transferta të fondeve të projektit. Pengesë për lëvrimin e fondeve të kredisë është bërë dhe mospërfshirja e projektit në planin limit të Ministrisë së Brendshme për vitin 2012, duke bërë që të mostërhiqen fondet që janë në llogaritë e BB dhe në Bankën e Shqipërisë.

Konstatohet se nuk janë respektuar përqindjet e financimit sipas kontributit të donatorëve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit të kredisë me IBRD, për arsye se nga fondet e kredisë IBRD nga 50% të parashikuara janë financuar në masën 50.17% ose 1,498,110 USD, pra 0.17%

më shumë, nga kontributi i bashkive pjesëmarrëse nga 30% i parashikuar janë financuar në masën 29.77% ose 887,079 USD, pra më pak në masën 0.23% dhe nga fondet e Qeverisë Shqiptare nga 20% të parashikuara janë financuar në masën 20.12% ose 600,668 USD, pra 0.12% më shumë se masa e kontributit të llogaritur në marrëveshjen financiare.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marri masat për projektet me financime të huaja në të ardhmen, të monitoroj disbursimet e fondeve të akorduara nga donatorët duke respektuar përqindjet e financimit sipas kontributit të donatorëve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit të kredisë, në përputhje me programin e zbatimit të projektit dhe sipas grafikëve të përcaktuar në marrëveshjet e veçanta të financimit nga donatorët.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Grupi ndërmintor nuk ka të dokumentuar me procesverbale takimet për shqyrtimin e raporteve të vlerësimit të ecurisë së projektit, raporteve të auditimit dhe vlerësimit të anketimit të klientëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 280, datë 14.12.2006 “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës për zbatimin e projektit të administrimit dhe menaxhimit të tokës”.

Mungojnë shkresat për emërimin e stafit të Njesisë së Zbatimit të Projektit, veprim i cili është në kundërshtim me Manualin Financiar dhe Manualin Operacional të projektit LAMP.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marrë masa për të zbatuar me përpikmëri në kohë dhe në cilësi të gjitha angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshjet e Huasë për financimin e projektit, të miratuara me Ligjin nr. 9965, datë 24.07.2008 dhe me Ligjin nr. 40/2012, datë 12.04.2012, në lidhje me mënyrën e raportimit të donatorët, ritmet e disbursimeve, me qëllim realizimin e objektivave dhe komponentëve të projektit.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Konstatohet se megjithëse investimi ka përfunduar në muajin Nëntor 2011, ka mbetur vlera prej 5% (Garancia e Kontratës) në shumën 4,589,340 lekë. Ky fond është ende disponibël në Thesar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Punëve të Brendshme, të marrë masa për likuidimin e garancisë në vlerën 4,589,340 lekë, pagesë e cila duhet të kryhej në Nëntor 2013, sipas kontratës të nënshkruar midis palëve.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kryer në lidhje me planifikimin e fondeve për komponentin C.4, konstatohet se nga ana e Njesisë së Zbatimit të Projektit, nuk është parashikuar që në fillim të zbatimit të projektit, në mënyrë analitike kërkesat dhe nevojat për fonde që duhen për koston operative të projektit, për blerje të ndryshme dhe fondet për shërbime konsulence. Grupi i auditimit disponon vetëm të dhënat në lidhje me financimin në fakt të zërave për këtë kategori, për pasojë nuk mund të bëjmë një analizë të mirëfilltë se si dhe sa janë parashikuar nevojat për koston operative për projektin.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marrin masat në të ardhmen për projektet me financime të huaja, për të bërë planifikimin e fondeve sipas komponentëve dhe kategorive në përputhje me nevojat dhe kërkesat për fonde për kostot operative për projektet, me qëllim që financimi i zërave të kostos, të bëhet në përputhje me programin e zbatimit të projekteve dhe sipas grafikëve të përcaktuar në marrëveshjet e veçanta të financimit nga donatorët.

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kryer u konstatua se, nuk është kryer auditim nga kompani audituese të pavarura ndërkombëtare, në kundërshtim me marrëveshjen e financimit të huasë, megjithëse projekti ka përfunduar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marrin masat në të ardhmen për projektet me financime të huaja, të kryhen auditime nga kompani audituese të pavarura ndërkombëtare, në zbatim të marrëveshjeve të veçanta të financimit nga donatorët.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Në përfundim të projektit Njësia e zbatimit të projektit LAMP (menaxhimi dhe administrimi i tokës), ka kryer rakordimet me Bankën Botërore, ku rezultoi se nga veprimet e pagesave me monedha të ndryshme janë krijuar humbje nga kursi i këmbimit në shumën 20,600,000 lekë. Huamarrësi, në këtë rast Ministria e Brendshme, e ka si detyrim të kthejë tek donatorët vlerën e pashpenzuar nga Huaja IBRD si dhe humbjet nga konvertimet e valutës, të cilat përbëjnë rëndim të kostos së projektit në shumën 20,600,000 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Punëve të Brendshme, nisur nga niveli i lartë i humbjeve nga kurset e këmbimit, efekti negativ që ato kanë në buxhetin e shtetit për vitin 2015, të analizoj përgjegjësitë për këtë vlerë të konsiderueshme dhe që nuk është parashikuar në fondet e projektuara.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve civile, në investimet e kryera në bashkitë: Shkodër, Elbasan, Berat dhe Kamëz, janë konstatuar dëmtime të zërave të ndryshëm të punimeve të kryera për arsye të mungesës së mirëmbajtjes dhe keqpërdorimit të investimeve. Drejtoritë e mirëmbajtjes të Bashkive respektive, nuk kanë kryer mirëmbajtjen e investimit duke mosrespektuar një nga kushtet për miratimin dhe kryerjen e investimeve në këto bashki sipas marrëveshjeve të lidhura midis bashkive dhe Ministrisë së Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Punëve të Brendshme të marri masat referuar detyrimeve nga projekti “LAMP” për ti kërkuar bashkive që kanë përfituar investime nga ky projekt, të respektojnë kushtet e marrëveshjes dhe të kryejnë mirëmbajtjen e investimeve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

Janë kryer procedura prokurimi me objekt “Artikuj kancelarie” dhe “Mobilje-Paisje zyre”, ku konstatohet se nuk janë hartuar kërkesat për këto materiale, si edhe për prokurimin me objekt “Sigurim kasko e plotë për automjetin e projektit dhe për blerje blu diesel”, nuk janë marrë oferta për të shpallur më pas ofertuesin me çmimin më të ulët, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, Kreu II, “Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i Procedurave”, pika 1, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit /Ministria e Punëve të Brendshme të marrin masat e nevojshme në të ardhmen për projektet me financime të huaja, që përpara kryerjes së një procedure prokurimi për blerje të merren të paktën tre oferta çmimesh dhe më pas të përcaktohet fituesi.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i projektit “Menaxhimi dhe Administrimi i Tokës”, u konstatua se dëmi në total i shkaktuar nga veprimet dhe mosveprimet e Njesisë së Zbatimit të Projektit dhe Bashkive tek të cilat janë kryer investimet, është në vlerën **24,030,005 lekë**.

1. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Blerja dhe instalimi i tabelave me emërtimet e bulevardëve, shesheve, parqeve, rrugëve, rrugicave në bashkitë e Beratit, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Fushë-Krujës, Gjirokastrës, Kamzës, Korçës, Krujës, Lushnjës, Shkodrës, Vlorës dhe Vorës” i vitit 2010, me vlerë totale 1,707,709 USD, u konstatuan diferenca në zëra punimesh në vlerën **43,179 USD**, përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik SHPK, duke shkaktuar **dëm ekonomik** për Ministrinë e Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme, të marri masa dhe ti kërkojë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **43,179 USD**, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt “Blerja dhe instalimi i tabelave me emërtimet e bulevardëve, shesheve, parqeve, rrugëve, rrugicave në bashkitë e Beratit, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Fushë-Krujës, Gjirokastrës, Kamzës, Korçës, Krujës, Lushnjës, Shkodrës, Vlorës dhe Vorës”.*

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqve & Lagjia nr.2 Kamëz” i vitit 2009, me vlerë totale 76,846,220 lekë, u konstatuan vonesa gjatë ekzekutimit të kontratës me 166 ditë. Referuar penealiteteve të përcaktuara në nenin 34 të kontratës së lidhur midis palëve, rezulton se vlera e penalitetit për vonesat e shkaktuara nga operatori ekonomik SHPK është **1,275,647 lekë, e cila përbën dëm ekonomik**. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Kamëz, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme dhe Bashkia Kamëz të marrin masat dhe ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës **1,275,647 lekë**, përfituar padrejtësisht nga vonesat gjatë ekzekutimit të punimeve në kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqve & Lagjia nr.2 Kamëz”, për buxhetin e Bashkisë Kamëz në masën 30%, për buxhetin e pushtetit qendror në masën 20% dhe për Ministrinë e Brendshme në masën 50%.*

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqve & Lagjia nr.2 Kamëz” viti 2009, dhe vlerë totale 76,846,220 lekë, u konstatuan diferenca në zëra punimesh duke përfituar padrejtësisht operatori ekonomik SHPK vlerën **1,340,332 lekë**, duke shkaktuar dëm ekonomik. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Kamëz, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Kamëz të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës **1,340,332 lekë**, të përfituar padrejtësisht për diferencat në zërat e punimeve, në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqve & Lagjia nr. 2 Kamëz”, për buxhetin e Bashkisë Kamëz në masën 30%, për buxhetin e pushtetit qendror në masën 20% dhe për Ministrinë e Brendshme në masën 50%.*

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve nga shoqëria SHPK, në Bashkinë Berat, u konstatua dëm ekonomik në shumën **2,440,798 lekë**, për punime të pakryera dhe vonesa në zbatimin e kontratave, si më poshtë:

-Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Ndërtimi i Tregut Industrial Berat” i vitit 2010, me vlerë totale 77,762,401 lekë, u konstatuan vonesa gjatë ekzekutimit të kontratës me 293 ditë. Referuar penealiteteve të përcaktuara në nenin 34 të kontratës së lidhur midis palëve, rezulton se vlera e penaltetit për vonesat e shkaktuara nga operatori ekonomik SHPK është **2,278,438 lekë, e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Ndërtimi i Tregut Industrial Berat” i vitit 2010, me vlerë totale 77,762,401 lekë, u konstatuan diferenca në zëra punimesh në vlerën **162,360 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** duke përfituar padrejtësisht operatori ekonomik SHPK.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Berat të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të

gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 2,440,798 lekë, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt “Ndërtimi i Tregut Industrial Berat”. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Berat, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Ndërtimi i Rrugës Lidhëse të Tregut Industrial të Qytetit të Beratit” viti 2012, me vlerë totale 2,335,460 lekë, u konstatuan diferenca në zëra punimesh në vlerën **37,824 lekë**, duke shkaktuar **dëm ekonomik**, përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik SHPK. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Berat, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Berat të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 37,824 lekë, të përfituar padrejtësisht për diferenca në zëra punimesh në tenderin me objekt “Ndërtimi i Rrugës Lidhëse të Tregut Industrial të Qytetit të Beratit”. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Berat, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit” i vitit 2010, procedurë e hapur me fond limit 60,077,988 lekë, është shpallur fitues dhe është lidhur kontrata midis Bashkisë Elbasan dhe operatorit ekonomikSHPK me vlerë 63,266,604 lekë. U konstatuan shkelje të ligjit të prokurimit publik në nxjerrjen e urdhrin të prokurimit, në vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe në shpalljen e fituesit duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën e 3,188,639 lekë**. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Elbasan, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Elbasan të marrin masat që të kërkojnë nga personat përgjegjës, z....., njësia e prokurimit e përbërë nga z....., znj....., z....., z....., znj..... dhe komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga z....., z....., znj....., znj..... dhe z....., vlerën e **dëmit ekonomik** të shkaktuar në shumën **3,188,639 lekë**. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Elbasan, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.*

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit” viti 2010, dhe vlerë totale 79,789,132.00 lekë me tvsh, u konstatuan diferenca në zëra punimesh duke përfituar padrejtësisht operatori ekonomik SHPK dhe duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën e 3,647,181 lekë** nga të cilat, për buxhetin e Bashkisë Elbasan në masën 30%, për buxhetin e pushtetit qendror në masën 20% dhe për Ministrinë e Brendshme në masën 50%.

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Të merren masa nga Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Elbasan që ti kërkojë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **3,647,181 lekë**, të përfituar padrejtësisht si vlerë që i përket diferencave në zëra punimesh në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit”, për buxhetin e Bashkisë Elbasan në masën 30%, për buxhetin e pushtetit qendror në masën 20% dhe për Ministrinë e Brendshme në masën 50%.*

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kontratave të nënshkuara për kryerjen e punimeve nga SHPK, në Bashkinë Shkodër, u konstatua dëm ekonomik në shumën **6,788,605 lekë**, për punime të pakryera dhe vonesa në zbatimin e kontratave, si më poshtë:

-Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve” i vitit 2011, me vlerë totale 79,999,590 lekë, u konstatuan vonesa gjatë ekzekutimit të kontratës me 33 ditë. Referuar penealiteteve të përcaktuara në nenin 34 të kontratës së lidhur midis palëve, rezulton se vlera e penaltetit për vonesat e shkaktuara nga operatori ekonomik SHPK, është **263,998 lekë, e cila përbën dëm ekonomik.**

-Në zbatimin e punimeve civile në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve” i vitit 2011, me vlerë totale 79,999,590 lekë, u konstatuan diferenca në zëra punimesh duke përfituar padrejtësisht operatori ekonomik SHPK dhe shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 6,524,606 lekë.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Ministria e Brendshme, Njësia e zbatimit të Projektit, Bashkia Shkodër të marrin masa që ti kërkojnë operatorit ekonomik SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **6,788,605 lekë**, të përfituar padrejtësisht në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike - Shtëpia e Bujqëve”. Referuar marrëveshjes së financimit, 30% e kësaj vlere është për buxhetin e Bashkisë Shkodër, 20% për buxhetin e pushtetit qendror dhe 50% për Ministrinë e Brendshme.*

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE.

I. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan, që në mënyrën dhe rrugët e

përcaktuara nga ligji, të ndërmarrë masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për 13 punonjës të Bashkisë Elbasan, për arsye se:

-Fondi limit në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit”, është i pa argumentuar e i pa miratuar nga Ministria e Brendshme, gjithashtu rezultoi të jetë rritur fiktivisht dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit, pika 1 dhe pika 2, Kreu II, Organizimi i Prokurimit Publik, neni 12, Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor, Kreu V, Zhvillimi i Procedurave, pika 1 dhe pika 2, neni 48, paraqitja dhe pranimi i ofertave, neni 53, shqyrtimi i ofertave, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 1, Zhvillimi i Procedurave, pika 2, Hartimi i Dokumentave të Tenderit, pika 3, dorëzimi i ofertave, pika 4, hapja dhe vlerësimi i ofertave.

-Si anëtarë të grupit të marrjes në dorëzim të objektit “Rikonstruksioni i fasadave të pallateve në qytetin e Elbasanit” kanë vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me UKM nr. 1, datë 16.6.2011, pikat 3.2, 3.3,4, pika 5 shkronja a, pika 4 shkronja c, e, ë, f, n, rr, sh, t, th, në kundërshtim me nenin 26 të kontratës së lidhur midis palëve, “Testimet dhe inspektimet”, pikat 26.3, 26.4 dhe 26.5 dhe kanë marrë në dorëzim objektin me diferenca në volume.

II. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Berat, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarrë masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për Drejtorin Juridike të Bashkisë Berat (Për fazën e Projektit) dhe për 7 anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim të objektit “Ndërtimi i tregut Berat”, për arsye se:

-Nuk ka menaxhuar juridikisht siç duhet kontratën bazë dhe ato shtesë për procedurat me objekt “Ndërtimi i Tregut Berat” dhe “Rruga Lidhëse e Tregut Berat” duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, nenin 33 dhe nenin 35 të kontratës së lidhur midis palëve dhe duke lidhur kontrata shtesë tek të cilat përmbajtja është në kundërshtim me ligjin.

-Si anëtarë të grupit të marrjes në dorëzim të objektit “Ndërtimi i Tregut Berat” dhe objektit “Rruga Lidhëse e Tregut Berat” kanë vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me UKM nr. 1, datë 16.6.2011, pikat 3.2, 3.3,4, pika 5 shkronja a, pika 4 shkronja c, e, ë, f, n, rr, sh, t, th, në kundërshtim me nenin 26 të kontratës së lidhur midis palëve, “Testimet dhe inspektimet”, pikat 26.3, 26.4 dhe 26.5 dhe kanë marrë në dorëzim objektin me diferenca në volume.

III. Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Kamëz, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarrë masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore, për Drejtorin Juridik në Bashkinë Kamzë dhe tre anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim të objektit “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqce & Lagjia nr. 2 Kamëz”, për arsye se:

-Nuk ka menaxhuar juridikisht siç duhet kontratën bazë dhe ato shtesë duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, nenin 33 dhe nenin 35 të kontratës së lidhur midis palëve dhe duke lidhur kontrata shtesë tek të cilat përmbajtja është në kundërshtim me ligjin.

-Nuk ka respektuar ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publik i ndryshuar, kreu V, zhvillimi i procedurave, pika 1, germa a dhe b, duke caktuar në njësinë e prokurimit dy nëpunës dhe jo të paktën tre siç ligji e parashikon.

-Si anëtarë të grupit të marrjes në dorëzim të objektit “Rikonstruksioni i rrugëve Radiostacioni-Azili i Pleqce & Lagjia nr. 2 Kamëz” kanë vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me UKM nr. 1, datë 16.6.2011, pikat 3.2, 3.3,4, pika 5 shkronja a, pika 4 shkronja c, e, ë, f, n, rr, sh, t, th, në kundërshtim me nenin 26 të kontratës së lidhur midis palëve, “Testimet dhe inspektimet”, pikat 26.3, 26.4 dhe 26.5 dhe kanë marrë në dorëzim objektin me diferenca në volume.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 6, 7, 8 dhe neni 15, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pikat, 4, 5, 5/1, të Kreut I dhe të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreut I, pikat 3, 8, 8/1, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Shkodër, **të vendos masë administrative me gjobë për subjektin** sh.p.k dhe Kolaudatorit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve civile të tenderit me objekt **“Rikonstruksioni i rrugës Zooteknike – Shtëpia e Bujqve”** me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **6,524,606 lekë**.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Luljeta Shtylla, Altin Tafilaj dhe Enida Mata, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naco.